



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria:	Drejtoria e Planifikimit Strategjik
Periudha raportuese:	Muaji tetor, 2023
Emri dhe mbiemri i raportuesit:	Mimoza Sylejmani Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik

PROJEKTET:

- Përmirësimi i pjesës grafike (intervenim në të gjitha hartat dhe skenarët);
- Përpilimi i hartave në formatin PDF dhe JPG;
- Përditësimi i kërkesave të qytetarëve;
- Kompletimi i dokumentit të PZHK-së për dorëzim në MMPHI, për dhënien e lejes për diskutim publik.

AKTIVITETET:

- Gjatë muajit tetor në Sektorin e planifikimit janë trajtuar gjithsej 56 lëndë;
- Informimi i palëve për kriteret e planeve në ditët e caktuara me palë;
- Caktim i grupit punues për: Fillimi i revidimit të PRRH-së, "Prishtina e Re - Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual/njësi hapësinore I,L,G;
- Caktim i grupit punues për: Fillimi i revidimit të PRRH-së, "MATI 1" për bllokun A-11;
- Hartimi i arsytimit për Propozim-vendimin për fillimin e revidimit të PRRH-së "Lakrishtë" për bllokun A-3, A-4, A-5, A-6, A-7, A-8.

TAKIMET:

- **Takim me kabinetin dhe drejtorinë përkatëse për përmbylljen e diskutimeve në lidhje me dokumentin e PZHK-së para dorëzimit në MMPHI;**
- **Takime të rregullta me Kompaninë “GM Architects” lidhur me definimin dhe hartimin e Master-planit për rigjenerimin e lagjes “Kodra e Trimave 2”;**
- **Takim pune me grupin punues për hartimin e PRRH-së, të lagjes “Kalabria”;**
- **Takime me operatorin ekonomik “Shërbimi i arkitektit të Kryeqytetit”, - koordinimi i procesit të hartimit të projekteve;**
- **Takim me përfaqësuesit e Kishës Protestante lidhur me zbatimin e Vendimit / 2016, për caktimin e lokacionit për varreza.**